

Prishtinë, 28.09.2006

Komentet prej MEM-it dhe KEMA/ KOSTT mbi draft licencat, shqyrtuar pas seancës publike të mbajtur më 14.09.2006

Deri më 13.09.2006 ne kemi analizuar komentet që kemi marrë prej KEK SH.A, KOSTT, Triangle, EGL dhe konsulentëve nga KEMA dhe NERA. Këto komente janë marrë parasysh në draft licencat që i janë dërguar të gjithë aplikantëve dhe publiku i ka marrë të përmbledhura së bashku me përgjigjet tona, gjatë seancës publike të mbajtur më 14.09.2006. Kjo përmbledhje komentesh dhe përgjigjet ndaj tyre janë botuar në faqen tonë elektronike: www.ero-ks.org.

Gjatë seancës publike të mbajtur me 14 Shtator kemi analizuar procedurën e aplikimit, dispozitat dhe bazën ligjore për të gjitha format e draft licencave veç e veç.

Ndërkohë kemi marrë komente prej MEM-it mbi licencat për gjenerim, dhe furnizim/tregtim, dhe prej KOSTT-it dhe konsulentëve / KEMA mbi licencat për Operatorin e Tregut dhe Operatorin e Sistemit të Transmisionit.

Komentet prej MEM-it mbi Licencat për Gjenerim për KEK SHA (Kosova A dhe Kosova B):

MEM- Komenti për Pjesën I, Neni 5 dhe 6 bazohen në faktin se Kosova A dhe B duhet të plotësojnë kërkesat e konsumatorëve kosovarë, që furnizohen nga KEK-u në pajtim me Licencën për Furnizuesin Publik. Gjenerimi i KEK-ut nuk duhet të lejojë ose të sugjerojë që furnizimi i kufizuar me energji t'i shitet ndonjë blerësi tjetër, përveç kur variacionet sezonale ditore të ngarkesës mund të sigurojnë mundësi për shitje ekonomike ose shkëmbime që sjellin përfitime neto për konsumatorët me pakicë të KEK.

Ne sugjerojmë plotësimin e paragrafit 6) me **“Pas plotësimit të kërkesave të furnizuesit publik nga paragrafi 5”** i licencuari mund të shesë energjinë elektrike të gjeneruar nga vetë ai, ose kapacitetin e centralit të vet energjetik, me çmime të negociueshme për.....”

ZRRE- Gjuha e Nenit 5 ku **“I Licencuari duhet t'i ofrojë furnizuesit publik energjinë elektrike të prodhuar nga centralet e veta energjetike me çmim të rregulluar”** dhe Neni 6 ku **“I Licencuari mund të shesë energjinë elektrik të gjeneruar nga vetë ai, ose kapacitetin e centralit të vet energjetik, me çmime të negociueshme për ...”** përcaktojnë qartë prioritetet. Detyrimi i Shërbimit Publik përfshihet edhe në Nenin 17 të të dyja licencave të gjenerimit (për Kosovën A dhe për Kosovën B).

Sidoqoftë, ne e kemi pranuar këtë koment për të forcuar detyrimin e shërbimit publik për licencën e gjenerimit. Kjo do të përfshihet në të dyja licencat e KEK SHA.

MEM- Neni 7 c) në Pjesën I, i jep të drejtën të Licencuarit që të "... lidhë kontrata për shitjen e energjisë elektrike sipas Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji"; Kjo shprehje duhet të fshihet pasi i gjithë kapaciteti dhe energjia e Kosovës A dhe B i dedikohen furnizimit publik.

ZRRE- pas përmbushjes së detyrimit të shërbimit publik sipas Nenit 17, KEK do të jetë në gjendje të shesë energji (p.sh. gjatë stinës së verës). Për këtë arsye, ne kemi përfshirë referencat përkatëse në 7 c) për të sqaruar këtë çështje.

7c) tani lexon: "... lidhë kontrata për shitjen e energjisë elektrike pas plotësimit të kritereve të përcaktuar në Nenin 17".

Komentet prej MEM-it për Licencën e Furnizimit Publik të KEKut

MEM- Në Neni 6, paragrafi 4, ZRRE pohon përgjegjësinë e vet rregullative për të shqyrtuar marrëveshjen për blerjen e energjisë në përputhje me Nenin 21.4 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

Sidoqoftë, në nenin 1 paragrafi 4 c) ka këtë fjali: c) blej kapacitete dhe energjinë elektrike nga gjeneratorët e tjerë **me çmime të parregulluar**, i cili duhet të fshihet pasi edhe pse është bazuar në Ligjin mbi Energjinë Elektrike, është në kundërshtim me autoritetin e ZRRE-së për të aprovuar blerjen e bërë nga furnizuesi publik.

ZRRE- kemi ndryshuar Nenin 1. paragraf 4 c) i cili tani është: ...blej kapacitete dhe energjinë elektrike prej gjeneratorëve të tjerë sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 6, paragrafi 4 i kësaj licence.

MEM- në disa seksione të këtij drafti janë përdorur shprehjet "tregtimin ndërkufitar" dhe "transit". Ne sugjerojmë që këto shprehje të hiqen prej licencës. Ndërsa furnizuesi publik mund të angazhohet në import dhe eksport, çdo aktivitet "transit" është përtej fushëveprimit të mandatit të tij.

ZRRE- ne jemi plotësisht dakord për këtë çështje; definicioni i "tregtisë ndërkufitare" është hequr si e panevojshme dhe "transiti" është fshirë nga kjo licencë.

Komentet prej MEM-it për Licencën Furnizimin / Tregti me Energji Elektrike të KEK-ut

MEM- Ndërkohë që kjo licencë është në përputhshmëri me kushtet e Ligjit mbi Energjinë Elektrike, ka një sërë aktivitetesh të kufizuara të cilat KEK-u mund t'i ndjekë si duhet sipas licencës së vet. Do të ishte më e përshtatshme nëse kjo licencë do të ndryshohej për të njohur një autorizim më të kufizuar. KEK nuk ka autoritet vetvetiu që të shesë, pasi i gjithë gjenerimi ekzistues i KEK-ut është ekskluzivisht i përkushtuar në përgjegjësitë e veta të furnizimit publik dhe ka nevojë për autorizim për t'u angazhuar në

marrëveshje import/eksporti, me qëllimin e kufizuar të furnizimit të konsumatorëve me pakicë.

ZRRE – në mënyrë që të sqarohet kjo çështje, kemi bërë disa modifikime në Nenin 4 në pjesën e I, që në draft ka qenë:

“4) Të licencuarit do t’i lejohet që:

- a) shesë kapacitet dhe energji elektrike për konsumatorët e privilegjuar me çmim të parregulluar;
- b) blejë kapacitet dhe energji elektrike prej prodhuesve me çmime të parregulluara;
- c) blejë dhe shesë kapacitet dhe energji elektrike prej tregtarëve të tjerë me çmime të parregulluara ...”
- d) importoj, eksportoj dhe kryen transitin e kapaciteteve dhe të energjisë...”

Tani ky Nen lexon:

4. pas përmbushjes së detyrimit të shërbimit publik të përcaktuar në Nenin 51.3 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, i Licencuari do të lejohet që:

- a) shesë kapacitet dhe energji elektrike për konsumatorët e privilegjuar me çmim të parregulluar;
- b) sipas nenit 23.3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike, blejë kapacitet dhe energji elektrike prej prodhuesve dhe tregtarëve të tjerë;
- c) blejë kapacitet dhe energji elektrike prej furnizuesit publik me çmime të rregulluara nëse kërkesa e konsumatorëve zvogëlohet krahasuar me kapacitetin të kontraktuar;
- d) importojë dhe eksportojë kapacitet dhe energji elektrike në përputhje me Nenin 36 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike ...

ZRRE- Kemi analizuar më tej përkufizimin (definicionin) e tregtimit në çdo licencë dhe kemi gjetur se –për shembull – në Licencën për Furnizim/Tregtim përkufizimi paraprak ka qenë: **“Tregti**: është biznesi i të licencuarit dhe ndonjë ortaku ose ndërmarrjeje të lidhur me të licencuarin për blerjen e kapacitetit dhe energjisë elektrike prej prodhuesve, me çmime të parregulluar, blerja dhe shitja e kapacitetit dhe energjisë elektrike prej tregtarëve të tjerë me çmime të parregulluar, blerja e kapacitetit dhe energjisë elektrike prej furnizuesit publik me çmime të rregulluar, dhe ndonjë faturim i shoqëruar, arkëtim dhe aktivitete të shërbimeve ndaj konsumatorëve”.

E njëjta gjuhë nga ky përkufizim është përfshirë në Pjesën e I në Nenin 4 i së njëjtës licencë. Në mënyrë që të shmangen përsëritjet, e kemi zëvendësuar me përkufizimin që jep vetëm referencë të Nenit përkatës në Licencë. Ky përkufizim tani lexon:

“Tregti është biznes tregtie i të licencuarit dhe ndonjë ortaku ose ndërmarrjeje të lidhur me të licencuarin, në përputhje me pjesën I, Neni 4 i kësaj licence”.

Këtë e kemi bërë në çdo licencë që përmban përkufizimin e tregtimit.

ZRRE – për Licencat e Furnizimit/Tregtimit (për EZPADA, EFT dhe EGL) sipas propozimit nga konsulentët – Pierce & Atwood.

Në Pjesën e I të shtohet Nenin i ri 5 për të siguruar që tregtarët do të regjistrojnë kompanitë e tyre në Kosovë në momentin kur fillojnë të furnizojnë konsumatorët e privilegjuar (kualifikuar). Kjo shtesë sugjerohet për të zgjidhur çështjen e regjistrimit të tregtarëve.

Bazat Ligjore: Neni 30 i Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë kërkon që ndërmarrjet energjetike që aplikojnë për licencë të regjistrohen në përputhje me ligjin e aplikueshëm në Kosovë. Rregullorja e UNMIK Nr. 2001/6 mbi Organizatat Afariste në nenin 1.2 përcakton se kjo rregullore është e aplikueshme vetëm për organizatat profitabile në Kosovë.

- a) Tregtarët janë kompanitë e huaja nuk janë fizikisht të pranishme në Kosovë dhe nuk tregtojnë fizikisht në Kosovë për shkak se energjia dorëzohet në kufi të Kosovës ku Transmisioni (KOSTT) ja transmeton KEK.
- b) tregtarët kanë një kontratë komerciale me KEK dhe nuk i furnizojnë askujt tjetër në Kosovë (KEK importon bazuar në licencën e vet dhe KOSTT e bën transmisionin bazuar në licencën e vet).
- c) Tregtarët nuk kanë asete në Kosovë;
- d) Regjistrimi ose mos-regjistrimi i tregtarëve në Kosovë nuk ndikon në buxhetin e konsoliduar të Kosovës pasi ata nuk paguajnë taksa.
- e) Tregtarët kanë operuar në Kosovë për disa vjet dhe nuk kanë pasur nevojë të regjistrohen gjatë kësaj kohe sipas ligjit ekzistues në Kosovë.
- f) Është në interes të Kosovës, KEK dhe gjithë konsumatorëve, që të ketë një numër më të madh tregtarësh që do të aplikojnë për tender në KEK në mënyrë që ky i fundit të blejë energji më të lirë dhe ta importojë për nevojat e furnizimit publik në Kosovë.

Për këtë arsye ne kemi përfshirë nenin e ri 5 në mënyrë që të sigurohet se në momentin kur tregtarët janë duke furnizuar konsumatorët e privilegjuar, do të duhet të regjistrojnë biznesin e tyre në Kosovë.

“5. Para se të fillon të angazhohet në ndonjë nga funksionet e furnizimit sipas Nenit 4, i Licencuari do të regjistrojë aktivitetin e tij sipas Nenit 30 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/6 mbi Organizatat Afariste dhe t'i sigurojë ZRRE-së dokumentin përkatës të regjistrimit.”

Komentet prej KOSTT-it / KEMA për draft Licencën e Operatorit të Tregut

KOSTT/KEMA – Referenca në Nenin 2.1 të Nenit 27.3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike, në Nenin 2.1 do të zëvendësohet me referencën në Rregullat e Tregut.

ZRRE- Komenti pranohet.

KOSTT/ KEMA - në Nenin 2.1 KOSTT beson se do të jetë e nevojshme të përfshihet përkufizimi (definicioni) i Rregullave të Përkohshme të Tregut.

ZRRE- Përkufizimi i Rregullave të Tregut përfshin fjalinë që mbulon këtë çështje**“Kjo përfshin çdo marrëveshje për transaksion të përkohshëm që mund të aprovet nga ZRRE-ja”**.

KOSTT/ KEMA- Në Nenin 4.2 – duke pasur parasysh vendimin e fundit të KOSTT për të qenë përgjegjës për menaxhimin e vëllimit të humbjeve të transmisionit dhe nevojën për KOSTT që të blejë energji, do të jetë e rëndësishme që të sigurohet se ky aktivitet është përjashtuar nga aktivitetet e tregimit.

ZRRE – Ky koment nuk ka lidhje me licencën e OT por me atë të Transmisionit dhe me shërbimet ndihmëse dhe humbjet që përfshihen në Licencën e OST-së.

KOSTT/ KEMA – Në lidhje me Nenin 5 do të ishte e dobishme që KOSTT të kuptojë nëse kjo është bërë për qëllimin e ndalimit të ndër-subvencioneve midis aktiviteteve të KOSTT OT dhe KOSTT OST; për shembull në afat të shkurtër do të ketë kursime në kosto nëse disa aktivitete si HR, IT dhe aktivitetet rregullative do të ndaheshin nga bizneset. Implikimi i këtij kushti është se kjo nuk lejohet as gjatë fazës së tranzicionit.

ZRRE – Ndarja e Kostove për HR ose IT dhe shërbime të zakonshme, nuk konsiderohet si ndër-subvencionim dhe do të ndahet në baza proporcionale midis 2 të licencuarve.

KOSTT/ KEMA – Në Nenin 7.1 futni numrin e përshtatshëm të ditëve prej datës së nxjerrjes së licencës deri në 1 dhjetor 2006.

ZRRE- në nenin 7.1 ne themi “brenda 120 ditësh prej nxjerrjes së kësaj licence ose në një afat më të shkurtër siç mund të përcaktohet nga ZRRE-ja ... “që zgjidh nevojën për të vendosur një Rregullat e Përkohshme të Tregut më 1 janar 2007. Afati përfundimtar prej 3 muajsh përfshihet në Nenin 15.2 (j) të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë .

KOSTT/ KEMA në Nenin 7.3 të shtohet “duke vijuar konsultimet e duhura me palët e prekura” që neni 7.3 të lexojë: “I Licencuari do të jetë përgjegjës për menaxhimin e çdo propozimi për modifikimin e Rregullave të Tregut, sipas dispozitave përkatëse në Rregullat e Tregut, dhe të paraqesë çdo ndryshim të modifikuar për aprovim në ZRRE, pas konsultimeve të duhura me palët e prekura.

ZRRE – Pranohet;

KOSTT/ KEMA – Në nenin 18, shtoni në fund të fjalisë “ku ky aprovim nuk mbështet në mënyrë të arsyeshme”

ZRRE – Ndryshimi në kontroll ndikon në aktivitetet e të licencuarit dhe për këtë arsye ai do të aplikojë në ZRRE për aprovimin e këtij ndryshimi. ZRRE ka mandat për të shqyrtuar këtë çështje dhe nuk ka të bëjë me ndonjë mbështetje të arsyeshme të aprovimit.

KOSTT/ KEMA – Në Nenin 20.1 b) në vend të “ndërmarrja e licencuar energjetike” përdorni termin KOSTT.

ZRRE- jemi dakord dhe termi “ndërmarrja e licencuar energjetike” është zëvendësuar me termin e përcaktuar “I Licencuari”.

Komentet e marra prej KOSTT / KEMA për draft licencën për e Operatorit të Sistemit të Transmisionit

KOSTT / KEMA - Neni 10.3 a) – për shkak të sqarimit më të mirë ne sugjerojmë zëvendësimin e shprehjes “nga territori në territor” me “prej territorit ku i licencuari kryen aktivitetet e veta, në Operatorin tjetër të Sistemit të Transmisionit jashtë territorit”;

ZRRE – Komenti pranohet.

KOSTT / KEMA – Sa i përket Nenit 10.4 i cili tani lexon:

“I Licencuari do të shqyrtojë çdo ditë deklaratën që referohet në paragrafin 3 dhe në rast të modifikimit, duhet menjëherë ta paraqesë në ZRRE për aprovim.”

Ne propozojmë që teksti i Nenit 10.4 të mund të zëvendësohet me: “I Licencuari do të shqyrtojë në mënyrë të rregullt kapacitetet ditore në dispozicion që janë identifikuar në deklaratën e referuar në paragrafin 3, dhe në rast të modifikimit, duhet menjëherë ta paraqesë në ZRRE për aprovim një deklaratë të korrigjuar”.

ZRRE- Jemi dakord.